L I G J
Nr. 8879, datë 15.4.2002

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT TEKNIK E FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISË"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1, 121 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e bashkëpunimit teknik e financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3310, datë 25.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE
PËR BASHKËPUNIMIN TEKNIK E FINANCIAR NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË

Bazuar në lidhjet miqësore midis dy vendeve,

Me dëshirën e forcimit të mëtejshëm të këtyre lidhjeve dhe zhvillimit të një bashkëpunimi të frutshëm teknik e financiar,

Duke pasur parasysh se zhvillimi i këtij bashkëpunimi teknik dhe financiar do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve sociale dhe në nxitjen e reformave politike, ekonomike dhe sociale në Shqipëri,

Kanë rënë dakort si më poshtë:

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë kanë rënë dakord të nxisin bashkëpunimin ekonomik e social ndërmjet dy vendeve. Programi i bashkëpunimit do të koordinohet nga Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë për Palën Shqiptare dhe nga Administrata Nërkombëtare Turke për Bashkëpunim (TICA) nën Këshillin e Ministrave për Palën Turke.

Qeveria e Republikës Turke, nëpërmjet TICA do të sigurojë asistencë teknike dhe trainim me projekte konkrete, duke përfshirë edhe përgatitjen e studimeve të fizibilitetit për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, duke bashkëpunuar me institucionet shtetërore dhe private nën koordinimin e Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë. Secila Palë do të caktojë ekspertët që do të identifikojnë dhe përgatisin projektet në fushat e listuara më poshtë. Fushat që do të përfshihen, të cilat mund të mos jenë të vetmet, do të jenë:

1. energjia;
2. infrastruktura (transport dhe telekomunikacion, etj.);
3. privatizim, programe rehabilitimi për kalimin në ekonominë e tregut;
4. sistemi financiar;

5. bujqësi, blegtori, ujitje, peshkim;
6. rehabilitimi i industrisë;
7. ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;
8. administratat lokale;
9. turizmi;
10. shëndetësia;
11. mjedisi;
12. arsimi, bashkëpunimi kulturor dhe shkencor;
13. vlerësimi i projekteve dhe blerjeve;
14. marrëdhëniet dhe organizatat ndërkombëtare (Banka Botërore, Agjensitë e Kombeve të Bashkuara, BERZH, OBT etj.);
15. marketingu dhe Tregtia e Jashtme.

Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Turqisë nëpërmjet TICA:

a) të hapë në Tiranë Zyrën e Koordinimit të Programit dhe të sigurojë pajisjen e saj me kompjuter dhe pajisje të tjera zyre;

b) të zgjedhë, të marrë dhe të paguajë personelin e nevojshëm për ZKP, përfshirë dhe stafin lokal;

c) të sigurojë mjetet e transportit për ZKP-në nëpërmjet blerjes ose qeramarrjes;

d) të paguajë pagat dhe udhëtimet ndërkombëtare për ekspertët turq;

e) të mbështesë financiarisht mbulimin e shpenzimeve të studimit të fizibilitetit;

f) të bëjë ndarjen e shpenzimeve të projekteve të asistencës teknike dhe të programeve të trajnimit;

g) të sigurojë konsulencë të nivelit të lartë, pa shpenzime, për koordinimin e ndihmës;

h) të lehtësojë fluksin e informacionit për të ndihmuar krijimin e programeve të informimit;

i) të sigurojë shërbimin mjeksor për specialistët shqiptarë, në bazë të legjislacionit turk dhe në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Turqi-Shqipëri në fushën e shëndetësisë, të firmosur më 6 prill 1989;

j) të paguajë qiranë e zyrës, si dhe shpenzimet për energji elektrike, ujë, ngrohje, gaz, etj.

Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nëpërmjet Ministrisë së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë:

a) të vërë në disponim të gjithë informacionin e kërkuar nga specialistët shqiptaro-turq gjatë identifikimit të projektit, hartimit dhe implementimit;

b) të mbulojë shpenzimet e specialistëve shqiptarë;

c) të vërë në dispozicion një zyrë të përshtatshme për ZKP-në;

d) të furnizojë ZKP-në me energji elektrike, ujë, pajisje për ngrohje dhe gaz;

e) të lehtësojë procedurat e regjistrimit të ZKP-së;

f) të sigurojë përfaqësuesit e TICA-s ZKP-së, me të njëjtin status, si dhe përfaqësuesit e organizatave të tjera për kohëzgjatjen e shërbimit të tyre në Shqipëri;

g) shërbimi shëndetësor për ekspertët e TICA–s do të sigurohet në bazë të legjislacionit Shqiptar në përputhje me parashikimet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit Turqi-Shqipëri në fushën e shëndetësisë, e firmosur më 6 prill 1998;

h) përjashtimin nga taksat doganore dhe TVSH-në e të gjithë materialeve që do të sillen për Shqipërinë nga TICA në kuadrin e ndihmës;

Projektet do të realizohen brenda kuadrit të kësaj Marrëveshje dhe do të implementohen nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta, duke përfshirë agjensi koordinimi dhe zbatimi të të dy vendeve.

Progresi i arritur në kuadër të kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi do të vlerësohet periodikisht çdo vit përmes mbledhjeve të ndryshme të vlerësimit. Në këto mbledhje, që do të zhvillohen në Turqi dhe Shqipëri në mënyrë alternative, do të marrin pjesë koordinatorët turq dhe shqiptarë si dhe përfaqësues të projekteve që janë miratuar ose për të cilët është rënë dakort nga koordinatorët e të dyja palëve.

Marrëveshja është nënshkruar më 12.10.2001 në gjuhët shqip, turqisht dhe anglisht, secila në dy kopje me vlefshmëri të njëjtë.

Marrëveshja do të hyjë pas marrjes së njoftimit të fundit nga Palët për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore përkatëse.

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së kësaj Marrëveshje është 5 (pesë vjet).

Koha e vlefshmërisë së Marrëveshjes do të zgjatet për pesë vjet të tjerë, në qoftë se asnjëra prej Palëve nuk do të njoftojë Palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për të ndryshuar ose për të anuluar marrëveshjen 3 muaj para përfundimit të tij.

Në rast kontradikte ndërmjet teksteve në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Ermelinda Meksi Ministre e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë	Prof.Dr.Abdulhaluk Mehmet Çay Ministër Shteti